



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.07.2021 merr këtë

V E N D I M

PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR MIRATIMIN E PAKOS EKONOMIKE EMERGJENTE "PRISHTINA 2"

- I. MIRATOHET Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2".
- II. a) Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësim-ndryshimi nënkupton plotësimin e nenit 2, pika 7, gjegjësisht lejimin e mjeteve financiare shtesë, në vlerë prej 51,000.00 €, për subvencionimin e 50 bizneseve, sipas shtojcës së listës së përfituesve;
b) Mjetet financiare të cekura si në piken II të këtij vendimi, do të merren nga Administrata, kodi buxhetor 22/16306 "subvencione dhe transfere".
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Drejtoria e Financave".
- IV. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, i dt. 11.06.2020.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-143947/21, më 22.07.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

